



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:133047  
Datë: 26.03.2024  
Numri i dokumentit: 05503936

**PPP.nr.162/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** - Departamenti i përgjithshëm, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit N.S. nga fsh ..., Komuna e Fushë Kosovës, të cilin e përfaqëson av Sabrije Jashari nga Prishtina, kundër debitorit B.A. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 26.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit B.A., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përbarimit P.nr.83/22, të datës 09.06.2022, i lëshuar nga Përbaruesi D.G. nga Prishtina dhe **MBETET NË FUQI** urdhri mbi lejimin e përbarimit P.nr.83/22, i datës 09.06.2022.

**A r s y e t i m**

Me urdhrin për përbarim P.nr.83/22, të datës 09.06.2022, Përbaruesi privat D.G. e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit N.S., kundër debitorit B.A., për përbarimin e aktgjykimit C.nr.625/11, të datës 28.02.2022, për pagesën e borxhit në shumë prej 288.60 euro dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 699.30 euro, si dhe shpenzimet e përbarimit, ose bllokimin e të gjitha llogarive bankare nëpër të gjitha bankat komerciale në emër të debitorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

I autorizuari i kreditorit, në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim i lëshuar nga Përmbaruesi privat D.G., me numër P.nr.83/22, i datës 09.06.2022, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.1, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se në këtë çështje përmbarimore kemi të bëjmë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike sepse unë debitori B.A. jetoj në fsh ..., KK Ferizaj dhe pa bazë ligjore është aprovuar padia e paditësit, kreditorit N.S. sipas aktgjykimit C.nr.625/11, të datës 28.02.2022, ku në cilësinë e të paditurit duhet të jetë personi B.O.A. nga fsh ..., KK Podujevë. Debitori i kësaj lënde është personi me emrin e njëjtë B.A. nga babai O., ndaj të cilit është marr aktgjykimi P.nr.368/08, i dt.12.02.2010, sipas propozim akuzës së PPK në Prishtinë, PP.nr.575-3/08, e datës 26.02.2008, Gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara sepse fillimisht gjykata gjatë vendosjes lidhur me prapësimin e ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, nuk ka kompetencë dhe të drejtë që ta bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së nxjerrjes së aktgjykimit C.nr.625/11, të datës 28.02.2022, sepse një gjë të tillë mund ta bëjë vetëm gjykata e shkallës së dytë, gjegjësisht Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë. Për më tepër, gjykata vlerëson se nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga provat të cilat i ka bashkangjitur vet debitori por edhe nga i autorizuari i kreditorit në përgjigjen e ushtruar në prapësimin e debitorit, siç janë aktgjykimi P.nr.368/08, i datës 12.02.2010, kopja e letërnjoftimit e debitorit B.A., kopja e propozim akuzës PP.nr.575-3/2008, e datës 26.02.2008, si dhe kopja e të dhënave të plota mbi regjistrimin e automjetit, e datës 29.12.2007, vërtetohet se kemi të bëjmë me person të njëjtë, gjegjësisht me debitorin e saktë siç është B.A.

nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, sepse shënimet të cilat janë dhënë në propozim akuzën e cekur më lart, përputhen në tërësi me të dhënat të cilat gjinden në letërnjoftimin e debitorit B.A. sepse data, muaji dhe viti i lindjes së debitorit, të cilat figurojnë në letërnjoftimin e debitorit, përputhen në tërësi me të dhënat e cekura në propozim akuzë por edhe në aktgjykimin C.nr.625/11, të datës 28.02.2022. Për më tepër, edhe të dhënat të cilat figurojnë në të dhënat për automjetet e datës 29.12.2007, sa i përket shënimeve rreth automjetit i cili është cekur në propozim akuzë, përputhen në tërësi në mes vete dhe bëhet fjalë për veturë të njëjtë, gjegjësisht me veturën e tipit Mazda .., me ngjyrë të kuqe, me targa të regjistrimit ..., e debitorit B.A., i cili është cekur në aktgjykimin C.nr.625/11, të datës 28.02.2022.

Andaj, duke i marr për bazë të gjitha faktet e përmendura më lart, Gjykata vjen në përfundimin se bëhet fjalë për debitorin e njëjtë, gjegjësisht për debitorin e saktë siç është B.A. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, të dhënat e të cilit janë të cekura në aktgjykimin C.nr.625/11, të datës 28.02.2022, në bazë të cilit është nxjerrë urdhri për përmbarrim i atakuar me prapësim.

Gjithashtu, Gjykata konstaton se përmbarruesi privat D.G., me rastin e nxjerrjes se urdhrin për përmbarrim P.nr.83/22, të datës 09.06.2022, është bazuar në nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, sepse në dispozitën ligjore të cekur më lartë është përcaktuar shprehimisht se si dokument përmbarrues në bazë të cilit organi përmbarrues e cakton përmbarrimin konsiderohet edhe aktgjykimi i lëshuar nga gjykata, siç është në rastin konkret aktgjykimi C.nr.625/11, i datës 28.02.2022, i cili e përmban klauzolën e përmbarrueshmëris për përmbarrueshmëri, e paraparë në nenin 36, par 1, të LPP-së, respektivisht aktgjykimi në fjalë është i plotfuqishëm nga data 15.04.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 09.05.2022 dhe i njëjti është në origjinal dhe kështu në këtë rast janë respektuar në tërësi dispozitat e nenit 36, par 1, të LPP-së

Përveç tjerash, gjykata konstaton se aktgjykimi i cekur më lart është në tërësi i përshtatshëm për përmbarrim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, pasi që në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, mjetet, shuma e cila është prej 288.60 euro dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 699.30 euro dhe koha e përmbushjes se detyrimit, siç është afati prej 15 ditësh, pas pranimit të aktgjykimit.

Si përfundim, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit në prapësim, përgjigjen me shkrim të autorizuarit të kreditorit në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ndërsa urdhri për përmbarrim P.nr.83/22, i datës 09.06.2022, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**PPP.nr.162/22, më datë 26.03.2024**

**GJYQTARI**

**Faton Ajvazi**

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimet të këtij aktvendimi.